



A.nr.495/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.495/2026, të datës 04.05.2026, të parashtruar nga ankuesi SH.I, nga Prishtina, kundër organit të punësimi: Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike – administrative “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 17.06.2026, nxjerrë këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.495/2026, e datës 04.05.2026, e parashtruar nga ankuesi SH.I.

II. Anulohet Vendimi me Nr.8, i datës 16.03.2026, i menaxherit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, ndërsa çështja *kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë, më detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të rishqyrtoj çështjen e njohjes së përvojës së punës së ankuesit në pajtim me pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

II. Obligohet Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që brenda afatit prej 15 ditës nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj çështjen e ankuesit si objekt i kësaj ankesë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe pikëpamjet juridike si në arsyetimin e këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi, SH.I (*tutje referuar ankuesi*), më datë 04.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos pagesën e përqindjes së përvojës së punës konkretisht diferencën financiare retroaktive nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Veteranët e Luftës së UÇK-së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 05.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit,

më datë 12.05.2026, ka dhënë përgjigje në ankesë, duke përcjell edhe shkresat materiale referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2153/2026 të datës 04.05.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; ID identifikuese e ankuesit; Përgjigjen në ankesë e datës 12.05.2026; Akt emërimi i datës 01.12.2021 i ankuesit; Përshkrimi i detyrave të punës; Lista e pagave; Vendimi me numër 8 i datës 16.03.2026; Kërkesa për njohjen e stazhit të dyfishtë dhe pagesë retroaktive sipas Ligjit për Veteranët e UÇK-së e datës 04.03.2026 drejtuar Komunës së Prishtinës dhe Certifikata e Veteranit Luftëtar i UÇK-së e datës 27.07.2015.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, sepse:

I. Gjendja e fakteve

Nga administrimi i provave materiale rezulton se:

- Ankuesi sipas Aktit të Emërimit me numër AE.Nr.01-112-616 i datës 01/12/2021, mbanë pozitën Zyrtar i Lartë i Personelit në Komunën e Prishtinës.
- Me datë 27.07.2015, ankuesi është certifikuar si Veteran Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Interesuarit të UÇK-së.
- Me datë 04.03.2026, ankuesi ka parashtruar kërkesë për njohjen e stazhit të dyfishtë dhe pagesën retroaktive sipas Ligjit për Veteranet e UÇK-së, në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës.
- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, më datë 16.03.2026, ka nxjerrë Vendimin me numër 8 të datës 16.03.2026, me të cilin ka pranuar përvojën e punës prej 24 vite e 11 muaj.

II. Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se edhe pse është njohur stazhi i dyfishtë dhe është rregulluar përvoja e punës, por nuk është realizuar pagesa e përqindjes së përvojës së punës (Nuk është bërë pagesa e diferencës financiare retroaktive nga data e hyrjes në fuqi e ligjit). Kërkon të shqyrtojë ankesën si shkelje e të drejtave nga institucioni punëdhënës; të obligojë institucionin që të bëjë rillogaritën e përqindjes së pagës bazuar në përvojën e njohur; te urdhërojë realizimin e pagesës së plotë të diferencës financiare retroaktive nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.

III. Vlerësimi i Kolegjit

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit Kolegji i Këshillit iu referua Rregullores (QRK) Nr.05/2023 për Pagën Bazë dhe Përvojën në Punë për të Punësuarit në Sektorin Publik, e zbatueshme nga data 6 qershor 2023, me theks të veçantë nenit 6 më të cilin është përcaktuar se: 2. *Përvoja e punës dëshmohej përmes njërës prej dëshmime si vijon: “2.1.përpara qershorit 1999: 2.1.1.dëshmime të ofruara nga njësia përkatëse e pensione në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensione; 2.1.2.librezës së punës me numrin amëz të të siguruarit (të kompletuar); 2.1.3.dëshmisë që vërteton se i ka paguar kontributet ai dhe/ose punëdhënësi ku ka punuar, dëshmi të cilat detyrimisht do të verifikohen nga zyrtarët e njësisë përkatëse të pensione në ministrinë përgjegjëse për fushën e pensione, sipas dispozitave të aplikueshme nga sigurimi pensional dhe invalidor i Kosovës deri në vitin 1989; 2.1.4.regjistrin të pagave; 2.1.5.kartelës së pagave; 2.1.6.vendimit apo kontrata për themelimin e marrëdhënies së punës; 2.1.7.formularit për paraqitje në sigurim dhe ndërprerje të sigurimit (MI,M-2); 2.1.8.vendimit për pagën, rritje dhe harmonizim; 2.1.9.vendimit për pushimin vjetor; 2.1.10. vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; 2.1.11. vendimit në origjinal të ish Bashkësisë Vetëqeverisëse të Interesit (BVI) së punësimit e në të cilin janë të shënuara të dhënat për stazhin e punës; 2.1.12. vërtetimit nga Agjencia Kosovare për Privatizim, për stazhin e punës në ndërmarrjet shoqërore; 2.1.13. dëshmisë-certifikatës për pagesën e kontributeve të lëshuara nga organi kompetent komunal në rastin e zëhtarëve privat; 2.1.14. vërtetimit të lëshuar në origjinal nga kompania private me vulë dhe nënshkrim, të shoqëruar me një deklaratë nën betim”. 2.2. pas qershorit 1999: 2.2.1. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga njësia kompetente për menaxhimin e personelit në Institucionet e Republikës së Kosovës ose nga misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë; 2.2.2. dëshminë mbi përvojën e punës të lëshuar nga ndërmarrjet publike ose nga ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë qenë ose janë nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim; 2.2.3. dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale për punëtorin; 2.2.4. dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent; 2.2.5. dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i një shteti të huaj në të cilin punëtori ka punuar; 2.2.6. çdo dëshmi tjetër të vërtetuar në procedurë gjyqësore përmes aktgjykimit të plotfuqishëm; 2.2.7. dëshmi tjetër plotësuese mund të konsiderohet edhe lista e pagave. 3. Njësia përgjegjëse për burime njerëzore në çdo institucion, në pajtim me këtë rregullore, vendosë për njohjen e përvojës së punës së një nëpunësi i cili merr pagë nga buxheti i Kosovës. Vendimi i përvojës së punës bëhet pjesë e dosjes së personelit për secilin i punësuar dhe ruhet sipas legjislacionit në fuqi 4. Të punësuarit aktual në sektorin publik të cilët e kanë të evidentuar përvojën e punës nuk i nënshtrohen zbatimit të paragrafit 3 të këtij neni..”*

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar Vendimi me numër 8, të datës 16.03.2026, të Menaxherit të Njësisë së Personelit të Komunës së Prishtinës, nga dhe konstatoi së më aktin në fjalë ankuesit i janë njohur gjithsej 24 vite e 11 muaj përvojë e punës, duke mos specifikuar qartë përvojën sipas institucionit dhe periudhës kohore, ndërsa, në pjesën arsyetuese të vendimit është dhënë vetëm një konstatim i përgjithshëm se nëpunësi SH.I ka paraqitur dëshminë e përvojës në deklaratën në betim dhe nga dosja personale, duke mos saktësuar njohjen e përvojës së punës se stazhit të veteranit të luftës.

Rrjedhimisht, sipas certifikatës të datës 27.07.2015, ankuesi është certifikuar si Veteran Luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Interesuarit të UÇK-së, dhe sipas thënies në ankesë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës përmes vendimit me numër 8 të datës 16.03.2026, i ka njohur ankuesin stazhin e dyfishtë të veteranit të luftës, mirëpo, sipas këtij akti nuk është specifikuar se për cilën periudhë ankuesit i është njohur e drejta e stazhit të dyfishtë të veteranit të luftës, fakt ky i domosdoshëm për përcaktim të efekteve retroaktive të kompensimit të përvojës së punës.

Andaj, referuar në rrethanat si më lartë, Këshilli erdhi në përfundimin që çështja e ankuesit duhet të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës me detyrimin që e njëjta në ri procedurë të nxjerr akt administrativ ashtu që përvoja e njohur e punës për ankuesin të përcaktohet në atë mënyrë që të individualizohet punëdhënësi dhe periudha kohore e angazhimit pranë këtij punëdhënësi, për çdo rast veç e veç, më theks të veçantë të specifikohet koha e njohjes se përvojës së stazhit të dyfishtë të veteranit të luftës.

Theksuar si më sipër, Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.495/2026

Merlinda RAMAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit, SH.I;
- Komunës së Prishtinës: Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.